

PROKURORISË THEMELORE NË PRISHTINË

Departamentit të Përgjithshëm

Në mbështetje të Nenit 79, paragrafi 1, në lidhje me Nenin 80, paragrafi 1, të Kodit nr. 04/1-123 të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, Dardan Molliqaj, në cilësi të Kryetarit të Partisë Social Demokrate, me datën 6 prill 2022, parashtron këtë:

KALLËZIM PENAL

Kundër Albin Kurti, Kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës, për shkak të kryerjes së veprës penale *deklarimet e rreme* sipas Nenit 384 të Kapitullit XXXI të veprave penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike sipas Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës Së Kosovës

s e p s e

Në vitin 2014, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin nr. 048/L-261 për Veteranët e Luftës Çlirimtare të Kosovës si një ligj të veçantë që ka trajtuar vetëm kategorinë e veteranëve të dalë nga lufta çlirimtare e udhëhequr nga UÇK-ja. Neni 4 i këtij ligji i ndanë në gjashtë kategori veteranët e Luftës Çlirimtare të Kosovës:

1. Veteran Invalid i luftës së UÇK-së;
2. Veteran Luftëtar i UÇK-së;
3. Veteran i Internuar i UÇK-së;
4. Veteran Ushtar i zhdukur (i pagjetur) i UÇK-së,
5. Veteran pjesëtarë i UÇK së; dhe
6. Veteran Pjesëmarrës i Luftës së UÇK-së.

Ligji nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre, në Nenin 3, Paragrafi 1, Pika 9, ku përcakton se Veteran i UÇK-së është qytetari i Kosovës dhe shtetasi i huaj i cili është radhitur në radhët e UÇK-së dhe është regjistruar si ushtar nga komandat (shtabet e zonave operative të UÇK-së), përkatësisht Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, gjatë periudhës 1997-1999. Për dallim prej tij, Ligji nr. 048/L-261 për Veteranët e Luftës Çlirimtare të Kosovës i ofron kuptim secilës prej gjashtë kategorive të sipërmendura në Nenin 3 të tij, përkatësisht Paragrafin 3, ku i përkufizon sipas tekstit si në vijim:

1. Invalid i luftës së UÇK –së – luftëtari, pjesëtari dhe i internuari (burgosuri) i UÇK- së, i cili ka pësuar plagë, lëndime (dëmtime) fizike dhe psikike apo sëmundje të rënda gjatë luftës ose në burgjet dhe kampet e armikut, gjatë periudhës së luftës, me shkallë të invaliditetit së paku 10%;
2. Veteran luftëtarë i UÇK-së – është qytetari i Kosovës dhe shtetasi i huaj i cili është radhitur në radhët e UÇK-së, dhe është regjistruar si ushtar i armatosur dhe i uniformuar nga komandat, shtabet e zonave operative të UÇK-së, përkatësisht Shtabi i Përgjithshëm i UÇK së, dhe i cili ka qenë aktiv deri në përfundimin e luftës;
3. I internuar i UÇK-së – secili person i cili për shkak të veprimtarisë së tij si pjesëtarë i UÇK-së është arrestuar gjatë periudhës 1997 -1999, dhe mbajtur në burg nga forcat e Serbisë;
4. Pjesëtarë i UÇK së - çdo person i cili me vendim apo akt tjetër është caktuar të kryej detyra konkrete në mbështetje politike, logjistike, financiare dhe detyra të tjera të marra nga komandantët e njësive, shtabeve dhe zonave të UÇK-së, përkatësisht Shtabi i Përgjithshëm i UÇK- së, gjatë periudhës 1997- 1999;
5. Pjesëmarrës i Luftës - ushtari, i cili është radhitur në radhët e UÇK-së, ka qenë i angazhuar në mënyrë aktive për të kontribuar në luftë, por për arsye të ndryshme i ka lëshuar radhët e UÇK- së, para përfundimit të luftës;
6. Ushtari i zhdukur (i pagjetur) i UÇK-së - veterani ose pjesëtari i UÇK-së, fati i të cilit ende nuk është zbardhur.

Ndonëse nuk është i shpallur në faqen zyrtare të internetit të Komisionit qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të veteranit UÇK-së dhe kategorive tjera, në media është raportuar dhe po ashtu nuk është mohuar asnjëherë nga z. Kurti se këtij të fundit i është njohur statusi i veteranit luftëtar të UÇK-së në kuadër të Njësisë Vartëse të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, listat e së cilës kategori nuk janë publike. Dihet se aktiviteti i z. Kurti në kuadër të luftës çlirimtare ka qenë i kufizuar në kontributin e tij të dhënë në kuadër të asaj që njihet si Zyra e Adem Demaçit për analiza, propozime dhe këshilla politike, e cila funksiononte në shërbim të të ndjerit z. Adem Demaçit, që atëkohë kryente detyrën e përfaqësimit politik të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së. Me datën 2 mars 1999, z. Kurti si pjesë e kësaj zyre, për shkak të mospajtimeve politike, përmes një deklarate publike, tërhiqet nga UÇK-ja dhe nuk kryen më asnjë funksion të njohur publikisht në shërbim të luftës çlirimtare deri kur i njëjti arrestohet në prill të këtij viti.

Provë: *Deklarata e datës 2 mars 1999 nga Zyra e Adem Demaçit për analiza, propozime dhe këshilla politik.*

Ligji nr. 048/L-261 për Veteranët e Luftës Çlirimtare të Kosovës përcakton tri kushte kryesore që një personi t'i njihet statusi i Veteranit Luftëtar – 1. të jetë qytetar i Kosovës apo shtetasi i huaj i cili është radhitur në radhët e UÇK-së; 2. Të jetë i është regjistruar si ushtar i armatosur dhe i uniformuar nga komandat, shtabet e zonave operative të UÇK-së, përkatësisht Shtabi i Përgjithshëm i UÇK së; dhe 3. të ketë qenë aktiv deri në përfundimin e luftës. Nga perspektiva e përkuqizimit të qartë se kësaj kategorie të veçantë të veteranit të UÇK-së, përkatësisht veteranit luftëtar, qartazi z. Kurti nuk mund të përmbushë dy kushtet e tij të fundit mu për faktin se asnjëherë nuk qenë i armatosur apo uniformuar, e për më tepër i njëjti ka dhënë dorëheqje publike nga kjo

organizatë politike e ushtarake. Z. Kurti mbase do mund të kualifikohej në kategori të tjera të përcaktuara me këtë ligj, mirëpo jo në këtë kategori – veteran luftëtar i UÇK-së.

Në këtë drejtim, Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës Së Kosovës, përkatësisht Neni 384 i tij përcakton si veprë penale deklarimet e rreme që mund të ofrohen nga palët në procedura administrative sikurse siç është rasti me statusin e veteranit luftëtar të UÇK-së të z. Kurti.

Andaj, nga sa u tha më lart, nuk ka asgjë kontestuese se z. Albin Kurti, Kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës, përmes veprimeve të ndërmarra ashtu siç janë përshkruar më lart, është i përfshirë në kryerjen e veprës penale *Deklarimet e rreme* sipas Nenit 384 të Kapitullit XXXI të veprave penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike sipas Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës Së Kosovës, andaj në këtë çështje kërkohet nga Prokuroria e Shtetit që të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme hetimore sipas autorizimeve dhe përgjegjësisë të saj sipas Kodit nr. 04/1-123 të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Dardan Molliqaj
Kryetar i Partisë Socialdemokrate

6 prill 2022
Prishtinë, Kosovë